



MA. 4745/ Prot
Dt. 08.08.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 524/1prot

Shkodër, më 04.08.2023

Lënda: Mbi vendimin Nr.58, datë 27.07.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 datë 02.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, në mbështetje të nenit 54 shkronja ç, nenit 55/2, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, VKM Nr.328/2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr. 326/2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, analizoj **VKB Vau Dejës Nr.58, datë 27.07.2023** “Për miratim të ndryshimeve të nivelit të pagave të bashkisë Vau Dejës për vitin 2023 me burim financimi VKB nr.84/2022 sipas shtesës së fondeve me anë të shkresës së Ministrisë së Financave & Ekonomisë Nr.12674, datë 10.07.2023 “Dërgohet rritja e pagave në zbatim të VKM-së Nr.328/2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.


Theksohet se struktura e policisë bashkiake nuk është pjesë e rritjes së pagave sipas VKM-së Nr.328/2023, për të cilën Prefekti është shprehur me VKB Nr.83/2022.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 58 Dt 27.07 .2023

PËR

“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NIVELIT TË PAGAVE PËR FUNKSIONARËT E ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, NËPUNËSIT CIVIL DHE PUNONJËSIT ADMINISTRATIV TË BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2023”

Bazuar në nenin 53 pika 2, neni 54 pika ç, e ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr 68/2017 ”Për financat e veteqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligji 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit 152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; VKM nr 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës bazë minimale në shkallë vendi”; VKM nr 328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, sipas VKB nr 84 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Vau Dejës, dhe me shkresë nr 24/1 dt 12.01.2023 të miratuar nga Prefektura Shkodër dhe sipas relacionit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi diskutoi materialin e paraqitur në mbledhjen e tij të datës 27.07 .2023

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023 si me poshte vijon:
 - Niveli i pagave për Administratën e Bashkisë ndryshohet sipas lidhjes 1.
 - Niveli i pagave për Qendren Sociale Rezidenciale ndryshohet sipas lidhjes 2
 - Struktura dhe numri i këshilltarëve dhe kryetarët e fshatrave sipas lidhjes 3.

2. Ky vendim i shtrinë efektet financiare nga data 01.04.2023 deri me datë 31.12.2023.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Fond i pagave përballohet nga transferta dhe të ardhurat e bashkisë
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Zv/Kryetare e Këshillit Bashkiak


Ardian Çelepija


Paola Pleshaj

Miratuar me 16 vota

Vota Pro 16

Vota Kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 01 . 08 . 2023 .